REPUBLIKA E KOSOVËS / REPU
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO Z
Nr/Br. 35,38/23
Datë/Datum. 27. 01. 2023
PRISHTINË - PR

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Anita Balaj	***17.01.2023***	***27.01.2023***	***35-38/23***

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **12.01.2023, OE "BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** si dhe më datë **13.01.2023 OE "N.T.P Bletaria EGZONI" - Gjakovë** ka parashtruar ankesë kundër Vendimit të AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit: **"Furnizimi me numra identifikues për bletë"-Ritender** me nr. të prokurimit: **40800-20-8639-1-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **670,000.00€.**

- Njoftim për kontratë – 31.12.2020
- Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara – 27.01.2021
- Procesverbali i hapjes – 29.01.2021
- Njoftim mbi Vendimin e AK – 16.02.2021
- Kërkesë për rishqyrtim në AK nga N.T.P Bletaria EGZONI – 03.03.2021
- Vendim i OSHP PSh.nr.196/21 – 30.03.2021
- Njoftim mbi Vendimin e AK - 20.04.2021
- Vendim i OSHP PSh.nr.380/21 – 25.07.2022
- Njoftim mbi vendimin për anulim – 30.12.2022
- Ankesa e paraqitur në OSHP – 12-13.01.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ankesa e I-rë: OE ankues: **"BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** në ankesën e tyre të datës 12.01.2023 pretendon se AK nuk i ka respektuar dispozitat si në vijim:

Neni 1 i LPP
Neni 2 i LPP
Neni 6 i LPP
Neni 7 i LPP
Neni 10 i LPP
Neni 52 i LPP
Neni 56 i LPP
Neni 59, paragrafi 4 i LPP-së
Neni 60, paragrafi 1.1 i LPP
Neni 62 i LPP
Neni 72 i LPP
Neni 7.4 i RRUOPP
Neni 41.2 i RRUOPP
Neni 43 i RRUOPP
Neni 44.5 i RRUOPP
Neni 108/A i LPP

Ankesa e II-të: OE ankues: **N.T.P Bletaria EGZONI" - Gjakovë** në ankesën e tyre të datës 13.01.2023 pretendon se AK nuk i ka respektuar dispozitat si në vijim:

Neni 1 i LPP
Neni 7 i LPP
Neni 59 i LPP
Neni 62 i LPP
Neni 44.5 i RRUOPP

Deklaratat detale mbi faktet dhe argumentet

Ankesa e parë e OE: **"BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** e parashtruar më datë 12.01.2023

AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT, me date 28.12.2022, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, por këtu mungojnë pasi qe AK as ne platformën elektronike e-prokurimi si dhe as përmes e-maili nuk na njofton/dërgon letrën standarde për tenderuesin e eliminuar/pasuksesshëm/suksesshëm, qe do thotë se AK – ZPP me këtë rast ka shkelur nenin 43 te RRUOPP-se, duke na vene ne lajthitje me qellim te caktuar qe ta humbim afatin për kërkesa për shqyrtim, duke marr edhe parasysh festat e fundit vitit vetëm qe ne te mos arrijmë te kapim afatet ligjore për kërkesën për rishqyrtim.

Gjithashtu, për faktin se ne me date 31.12.2022 ne ora 01:45 PM (që do te thotë AK -ZPP me qëllim te caktuar e ka vonuar deri me datën 30.01.2022 ora 15:25 duke marr parasysh edhe festat zyrtare për festat e ndërrimit te viot – moteve vitit te ri, duke na kufizuar qasje qëllimisht ne kundërshtim me **nenin 10 te LPP-se**, vetëm e vetëm te mos arrijmë te përgatitim kërkesë për rishqyrtim ne mënyrë te plote dhe te pa kufizuar sepse ne jemi te detyruar te hartojmë përgatitim kërkesën për rishqyrtim pa pasur qasje ne dokumentet te tenderit, duke vepruar ne kundërshtim me **nenin 10 par. 3 te LPP-se**, për faktin se ne këtë dispozite ligjore thuhet "qasje te arsyeshme" dhe te pa kufizuar apo te menjëhershme sepse **neni 7.4 te RRUOPP-se, thotë:** "*AK do ti ofroj, çdo palë te interesuar qe bëne kërkesë, qasje te shpejt dhe te arsyeshme ne te gjitha te dhënat për aktivitetin e prokurimit*" Prandaj pa vullnetin ton dhe me presionin dhe detyrimin e AK jemi te detyruar te parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim vet me date 03.01.2023 pa dokumentet qe do i kishim ne qasje dhe pa ekspertizën e Avokatit për te hartuar një kërkesë profesional dhe me argumente te arsyeshme qe do te mund ti kishim pas qasje ne dokumente. Prandaj, këtë duhet te merr për baze AK – ZPP – ESH.

Po ashtu, AUV - ZPP ka vonuar procesin e vlerësimit pa pasur asnjë arsye pasi kane nga vendimi OSHP PSH, 380/21 te 25.07.2022 deri me datën 30.01.2022 janë plote mbi 5 muaj (150 dite) kjo na bon te dyshojmë shume! Ku ne baze te kësaj mundem me konstatuar se është shkelur neni 41 te RRUOPP vlerësimi i ofertave duhet te kryhet me një afat sa me te shkurtër por jo me shume se 30 dite.

Sqarime për shtese pas Vendimit mbi refuzim te kërkesë për rishqyrtim për OSHP dhe ESH.
Edhe përkundër kërkeses tone për qasje ne dokumente, akoma ZPP nuk na ka lejuar qasjen duke arsyetuar se tash ka ndodhur KpR dhe s'ka kuptim, por dispozita ligjore e LPP-së askund nuk thote ashtu si ka menduar ZPP, por kjo është bërë krejt me një qëllim te caktuar dhe ne kundershtim te nenit 10 të LPP-së. Eksperti Shqyrtues te analizoj dhe trajtoj ne tërësi këto pretendim tone qe kemi parashtruar edhe ne KpR dhe tani kur po shkruajmë nuk na është lejuar qasja.

KERKOJM NGA ARKIVA E OSHP DHE NGA KRYETARJA E OSHP QE TE MOS JETE EKSPERTI SHQYRTUES z. Gjemail Bellanica, (TE CAKTOHET NJE EKSPERT TJETER NE SHQYRTIMIN E PRETENDIEMVE TONA) *sepse ashtu si ne ekspertizën e saj me lepër ne ekspertizën e dyte 380/22 te dates 18.05.2022 (fakte ne platformen elektronike) ka bere shkelje drastike te dispozitave ligjore te LPP, ku pas një vendimi te OSHP PSH nr. 196/21 te dates 30.03.2022 i cili e shpalle OE ankues si te papërgjegjshëm. KY EKSPERT SHQYRTUES PERSERI E TRAJTON PRETENDIMET E TLI DUKE SHKRUELR RENDE NENIN 113 DHE 114 dhe pas mbledhjes se informacioneve tonë i njëjti nuk ka deklaruar konfliktin e interest dhe shumë shpejt do te ju drejtohemi edhe institucioneve kompetente për marrjen e masave për shkelje te detyrave dhe përgjegjesive qe rrjedhin nga EKSPERTI SHQYRTUES.*

Prandaj krejt kjo është e qëllimshme nga AK – ZPP që ne të jemi te hendek epuar (pa informata) me rastin e përgatitjes se kërkesës për rishqyrtim edhe përkundër faktit se ne jemi shpallur 2 (dy) here radhazi si GOE te suksesshëm, gjithashtu edhe ne vendimin e OSHP PSH.nr. 196/21 te datës 30.03.2021 i cili vendim nuk na diskualifikon si GOE, i cili është i publikuar ne Platformën elektronike e-prokurim dhe e detyron AK qe te kërkoj sqarime shtese, mirëpo një gjë te tillë AK nuk na ka kërkuar, por përmes komisionit te vlerësimit konstaton se ne si GOE jemi te përgjegjshëm duke plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-së, kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor te dhënies se kontratës.

Prandaj pa vullnetin ton dhe me presionin dhe detyrimin e AK jemi te detyruar te parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim vet me date 02.01.2023 pa dokumentet qe do i kishim ne qasje dhe pa ekspertizën e Avokatit për te hartuar një kërkesë profesional dhe me argumente te arsyeshme qe do te mund ti kishim pas qasje ne dokumente. Prandaj, këtë duhet te merr për baze AK – ZPP – ESH

AK me rastin e anulimit te AP përmes njoftimi 058 vendimit mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit duke dhëne disa arsyetime ne këtë vendim si ne vijim:

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

DATË/A:	29/12/2022
PËR/ZA/TO:	Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit
Përmes	Flamur Kadrin, Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv
NGA/OD/FROM:	Jeton Gashi - Shef i Prokurimit
TEMA/SL/BRESKA/SUBJECT	Vendim mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 43 Udhëzimoja e Procedurave të Prokurimit paragrafi 1.1.5 pika 1 Udhëzimoi Operative për Prokurimin Publik gjithashtu sipas vendimit të OPKP-së numër 380/22 dhe eksportizës së ekspertit shqyrtues numër 380/21 Autoriteti kontrakt nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë njofton këtë:

VENDIM

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë anulon aktivitetin e prokurimit Furnizim me numra identifikues për bleta - Ritender 40800-20-8639-1-1-1 duke u bërë me ngritë dokumentacionin që autoriteti i kontraktues i jepëshë pra vendimit e OPKP-së, eksportizës e ekspertit shqyrtues dhe zgjedhjes sipas të procedurës dërrë me bërë.

Autoriteti kontraktues Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë anulon aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me numra identifikues për bleta - Ritender dhe me numër të prokurimit 40800-20-8639-1-1-1, arsyeja e anulimit të aktivitetit është që autoriteti kontraktues nuk ka pasur me vendim nga OPKP-ë që do e permbajnë kërkesën e prokurimit edhë në rastin e tij me fuqi apo anulimin e tij gjithashtu sipas kërkesës që janë bërë në këtë kohë e që janë shënuar te njoftimet me arsyë që kanë qenë me kërkesë kur kanë iniciuar procedurën e prokurimit. Mësë si rezultat edhë eksportizës e ekspertit shqyrtues ka bërë vërejtje ë numër i keqinformimeve i procedurës si të bazuar i eksportizës e cila është e ë web faqës e OPKP-së. Autoriteti kontraktues ka mësë pë bazë eksportizës e ekspertit shqyrtues ka me fund si së ka dërë ë konsiderë nga operatorët ekonomik që kanë paraqitur oferta edhë janë të angazhojnë dhë aktivitetë si e tillë ta analizohet dhë nesë autoriteti kontraktues ka interes mund ta shpall sërish gjithashtu

Ligjërisë juridike

Gjatë bërë vendimit janë e parë dispozitat e ligjit, siç janë sipas Nenit 108/A Ligjëshëm prokurimit e [illegible] paragrafi 1 pika 1.1 dhë 1.5 në Udhëzimin e Udhëzimit per Prokurimin dhë shërbimet [illegible] pika në 1 paragrafi 1.

Vendimet i dërgohen:

1. Operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë te prokurimit
2. Të gjitha palëve te interesuara
3. Arkivit te AUV-së

AK - ZPP te dhëne si me lart nuk kane arsyshmeri as profesional si dhe as baze ligjore sipas nenit 44.5 te RRUOPP dhe nenit 62 të LPP-së, andaj po japim argumentet dhe faktet e shkeljeve te dispozitave ligjore te LPP-së nga AK, si ne vijim:

Pretendimet e AK ne njoftimin B58 vendimin e AK te datës 30.12.2022, ne te cilin vendim thuhet se te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit janë te papërgjegjshëm, nuk qëndron për faktin se ne si GOE 2 (dy) here radhazi jemi shpallur te përgjegjshëm si GOE te suksesshëm duke na rekomanduar për dhënie te kontratës, prandaj përkundër obligimit ligjore AK – ZPP nuk na ka njoftuar përmes letrës standarde te eliminimit ne arsyetime te bazuara ne dispozita ligjore te LPP-se, duke shkelur edhe **nenin 43 te RRUOPP-se**, ku AK – ZPP ka qene i obliguar te na njoftoj përmes letrës standarde te eliminimit.

Alibia e AK – ZPP se ky aktivitet i prokurimit duhet te anulohet duke cituar raportet e ekspertit shqyrtues është e pa argumentuar, e pa bazuar, e pa qëndrueshme sepse vete AK, ZPP– Komisioni i vlerësimit – ZPP i kane kundërshtuar Raportet e Eksperti Shqyrtues lidhur me këtë lëndë - aktivitet te prokurimit dhe 2 (dy) here radhazi dhe na ka rekomanduar për dhënie te kontratës si GOE te suksesshëm dhe te përgjegjshëm, prandaj kjo dëshmohet edhe me Vendimin e PSH.nr 196/21 te datës 30.03.2021 nga faqe 8 deri ne faqen 12 te vendimit ne fjale, ku shume qarte pasqyrohen kundërshtimet e AK – ZPP karshi raportit te ekspertizës se .

Vlen te theksohet se ne kundërshtime te AK –ZPP ndër te tjera vet AK potencon se OE NTP Bletaria Egzoni Gjakove, e ku këto kundërshtime te AK karshi raportit te eksperti shqyrtues i konfirmon edhe PSH ne vendimin e vet nr. 196/21 te datës 30.03.2021 ne faqe 16 te vendimit ne fjale.

Gjithashtu, AK edhe me vendimin e vete datës 24.02.2021 gjate refuzimit te ankesave te parashtruara nga Mediatech Prinf Shpk, NPSH Planet, NTP Bletaria Egzoni dhe NTP Bletniri konfirmon se OE ankues ne fjale janë te papërgjegjshëm, ndërsa si OE i vetëm i përgjegjshëm sipas vet AK është vetëm OE BINA Shpk.

Nga sa u tha me larte rezulton se AK – ZPP me rastin e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit dhe arsyet e anulimit shërbehet me standarde te dyfishta dhe diskriminues, sepse kur i konvenon na rekomandon për dhënie te kontratës, dhe atë duke kundërshtuar vet raportet e eksperteve shqyrtues, ndërsa tani kur bene anulimin e aktivitetit te prokurimit thirret ne raportin e ekspertit shqyrtues dhe atë pa e specifikuar se ne cilin raport te ekspertit shqyrtues është thirrur. Po ashtu vlen te theksohet se AK nuk ka zbatuar Vendimet e PSH. nr. 196/21 te datës 30.03.2021 dhe PSH. 380/22 te datës 25.07.2022

PROVE: Bashkangjitur gjeni Vendimet OSHP PSH.Nr.196/21 te datës 30.03.2021
PSH. 380/22 te datës 25.07.2022

Ne jemi OE i përgjegjshëm për faktin se edhe pas vendimit te OSHP PSH. 380/21 te 25.07.2022, ku ne këtë vendim theksohet ne fq. 3 ku kërkon nga AK te kenë mjete buxhetore te zotuar si dhe ngritjen e konsiderueshëm te çmimeve qe do te thotë se AK janë te obliguar te kërkojnë nga OE te dëshmojnë interes material lidhur me këtë aktivitet te prokurimit. Ku ne GOE kemi vazhduar vazhdimisht vlefshmërinë e tenderit duke bindura AK se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe kemi interes material edhe përkundër rritjes se çmimeve ne pajtohemi te vazhdojmë te nënshkruajmë këtë kontrate ne këtë aktivitet te prokurimit. Po ashtu me te njëjtën datën kemi dorëzuar edhe deklaratën duke siguruar AK se ne jemi te gateshim te nënshkruajmë këtë kontrate me çmimet e ofertuar nga ana jone ne këtë aktivitet te prokurimit.

Prove: Vazhdimi i vlefshmërisë se tenderit me date 17.11.2022

Me vendimin e fundit te **OSHP PSH. 380/21 te 25.07.2022,** përmes se cilit vendim PSH – OSHP pa hedhë si te jashtë afateshme ankesën OE NTP Bletari Egzoni – Gjakove, e i cili OE definitivisht është i papërgjegjshëm dhe te njëjtit i janë shterur te gjitha mjetet juridike ne procedure administrative për atakimin e vendimeve te AK dhe **OSHP-së - (Res Judicata)**.

Te gjitha këto fakte dhe dëshmi te ofruar nga ana jone janë profesional dhe nuk mund te kontestohen nga asnjë profesionist, prandaj arsyetimet e dhëna nga AK janë arsyetime jo te mbështetura ne dispozita ligjore te LPP-se konkretisht nenit 62 të LPP-së.

AK me rastin e anulimit te aktivitet te prokurimit njoftimi B58 vendimi mbi anulimin e aktivitet te prokurimit ka shkelur nenin **1, 2, 7, 52, 56, 59, 60 dhe 62 te LPP-se** për faktin se me datën 30.12.2022 ka publikuar ne platformën elektronike e-prokurim.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 59 te LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edh kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas **nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Pra duke i pasur parasysh te gjitha faktet ne lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti te prokurimit, rezulton se AK-ja ka anuluar pa baze këtë aktivitet te prokurimit dhe ne kundërshtim me **nenin 62 te LPP-së**, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara ne këtë dispozite.

Ky anulim i këtij aktiviteti te prokurimit është bere ne kundërshtim edhe me **nenin 44.5 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP)**, sepse asnjeri nga kushtet e parashikuara ne këto dispozita nuk janë përmbushur ne këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore qe ky aktivitet i prokurimit te anulohet ne këtë faze.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veproje në mënyre transparente*", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar ketë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP – ESH qe te merr:

V E N D I M

APROVOHET, e bazuar ankesa e OE: **BINA SH.P.K. - Vushtrri**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se anulimin e aktivitetit pasi qe ka shkelur nenin 62 te LPP-se dhe lënda te kthehet ne
RIVLERESIM, Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjitha palët qe kane marr pjesë në këtë aktivitet te prokurimit.

Ankesa e dytë e OE: **"N.T.P Bletaria EGZONI" - Gjakovë** e parashtruar më datë 13.01.2023

Me dt.30.12.2022 është publikuar në E prokurim vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se :

> Autoriteti kontraktues Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë anulon aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me numra identifikues për bletë – Ritender dhe me numër të prokurimit 40800-20-8639-1-1-1, arsyeja e anulimit të aktivitetit është që autoriteti kontraktues nuk ka pasur një vendim nga OSHP që do e përfundonte këtë aktivitet të prokurimit çoftë në vazhdimin e tij më tutje apo anulimin e tij gjithashtu sipas rrethanave që janë tani në këtë kohë e që janë shumë të ndryshme me ato që kanë qenë në kohën kur kemi inicuar procedurën e prokurimit. Vlen të ceket edhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues ku janë cekur një numër i konsiderueshëm i pretendimeve si të bazuara (ekspertiza e cila është në uebfaqen e OSHP-së). Autoriteti kontraktues ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit shqyrtues ku në fund të saj ka cekur që asnjëri nga operatorët ekonomikë që kanë paraqitur ofertat nuk janë të përgjegjshëm dhe aktiviteti si i tillë të anulohet dhe njësi autoriteti kontraktues ka interes mund ta shpall serish gjithashtu.

Arsyeja e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar në ndonjë dispozitë konkrete ligjore.
AK-ja në arsyen e anulimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë, e ka cekur se ka marr për bazë ekspertizën e ekspertit shqyrtues e në të cilën ekspertizë është cekur se asnjëri nga OE nuk është i përgjegjshëm dhe se aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet.

Fillimisht arsyetimi i larteekur nuk qëndron për faktin se eksperti shqyrtues jep vetëm rekomandime për pretendimet ankimore të OE ankues, ndërsa paneli shqyrtues i OSHP-së i analizon dhe shqyrton edhe një herë dhe nxjerr një vendim final dhe meritor në lidhje me ato pretendime.
Në lidhje me ankesën tonë të fundit është nxjerr një vendim nga ana e OSHP-së e i cili vendim nuk i ka shqyrtuar ankesat e asnjërit nga OE ankues (i ka konsideruar si të jashtë afatit për shqyrtim), mirëpo edhe përkundër këtij fakti vendimi i paneli shqyrtues i nxjerrur në lidhje me ankesën tonë nuk ju ka obliguar që të bëni anulimin e aktivitetit të prokurimit. AK-ja në këtë rast është dashur të bëjë rivlerësimin e ofertave dhe më pastaj nëse ndonjë operator ekonomik ka pakënaqësi me vendimin e saj, mund ti drejtohet OSHP-së dhe më pastaj të shqyrtohet ankesa eventuale, mirëpo AK-ja në këtë rast është bazuar vetëm në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe jo në një vendim të panelit shqyrtues të OSHP-së.

Ne në këtë aktivitet të prokurimit ishim eliminuar me arsyetimin se A-testet janë prezantuar në gjuhën turke, ku edhe pse ne i kishim ofruar A-testet në gjuhën shqipe, të cilave ju figuron data para datës së hapjes pas sqarimeve shtesë, përsëri ishim eliminuar se kinse një interpretim nga KRPP sqaron se nëse ofrohen specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo që është përcaktuar tenderi i tillë duhet të eliminohet.

Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë ne e kemi cekur dhe po e ritheksojmë edhe një herë se ne A-testet i kemi prezantuar pas një lëshimi teknik në gjuhën turke, dhe të njëjtat nuk janë specifikime teknike të mostrave, mirëpo A-testet janë kërkuar të jenë të kryera për mostrën e pllakës. Pra kërkesa ka qenë ***"Pllaka duhet të ketë A-testet e kryera nga një institut shtetëror i cili garanton specifikat e lartë shënuara"***. Pra ne i kemi ofruar specifikimet teknike në gjuhën shqipe pra specifikimet teknike të mostrës janë ofruar në gjuhën shqipe, mirëpo A-testet i kemi ofruar në gjuhen turke pas një lëshimi teknik. Është shumë i qartë fakti se a-testet nuk hyjnë në specifikime teknike, mirëpo janë kërkuar për mostrën, andaj përderisa ne e kemi vërtetuar faktin se mos dorëzimi i testeve në gjuhën shqipe është një lëshim teknik dhe të njëjtave ju figurojnë datat para datës së hapjes së ofertave, ky veprim është dashur të konsiderohet si devijim i vogël në bazë të dispozitave të nenit 59.4 pika (ii) të LPP-së.

Nga sqarimi i larteekur kuptohet se në këtë rast ne jemi OE i përgjegjshëm, pasi që sikurse interpretimi nga KRPP që i është referuar eksperti shqyrtues, e po ashtu edhe konstatimi i ekspertit shqyrtues nuk kanë të bëjnë me këtë çështje, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ofrimin e specifikimeve teknike në gjuhë tjetër, mirëpo kemi të bëjmë me ofrimin e A-testeve të mostrës së një pllake, që në këtë rast kuptohet se nuk kemi të bëjmë konkretisht me specifikime teknike dhe A-testet në këtë rast nuk hyjnë në specifikime teknike.

Pra nga faktet e larteekura ne kërkojmë nga OSHP që të detyrojnë autoritetin kontraktues ta kthej lëndën në rivlerësim dhe asesi mos ta anuloj atë, për faktin se për këtë aktivitet të prokurimit ne jemi OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu duhet cekur fakti se që nga parashtrimi i ankesës në OSHP 05.05.2021 e deri para publikimit të vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, neve na është kërkuar vazhdimi i validitetit të ofertës.

Po ashtu duhet cekur fakti se OE i cili ka qenë i rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin paraprak të dt. 20.04.2021, ka qenë i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:
Ne pasi që kemi pasur qasje në dokumentet e OE Bina Delta-CCD Shpk , i kishim peshuar dhe matur mostrat e të njëjtit dhe të ofertuesve tjerë, ndërsa kishim vërtetuar faktin se i njëjti nuk i ka ofruar mostrat siç janë kërkuar tek aneksi 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme.

Është kërkuar si në vijim:
Pllaka për mbishkrimin e numrit:
Gjerësia - 5.6 cm
Gjatësia - 9.5 cm
Pesha - 8.2 gram
Mund të ndryshojë (+ - 10%)
Gjate matjes së mostrës së OE të rekomanduar për kontratë Bina Delta-CCD Shpk ka rezultuar se përsëri pesha e mostrës së pllakës është 10.30 gram, pra mostrat që i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë nuk përputhen me kërkesat tek aneksi 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme, ashtu sikurse në herën e parë e edhe tani pas rivlerësimit.
Faktin se mostrat e OE Bina Delta-CCD Shpk nuk janë sipas specifikimit teknik e kishte vërtetuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën Nr.196/21 TË DT.19.03.2021.

Gjithashtu OE Bina Delta-CCD Shpk është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i ka ofruar A-testet, mirëpo nuk ka ofruar fare fotografi se për cilën mostër janë kryer ato teste. Andaj ne dyshojmë se i njëjti ka ofruar A-teste për mostra të cilat nuk i ka prezantuar në ofertë. AK-ja të njëjtit i ka kërkuar sqarime shtesë ashtu siç e ka obliguar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr.196/21 të dt.30.03.2021, mirëpo OE Bina Delta-CCD Shpk me sqarime shtesë, jo vetëm që nuk ka ofruar fotografi me sqarime shtesë, mirëpo është arsyetuar se fotot nuk janë të rëndësishme sa përmbajtja. Nga kjo kuptohet shumë qartë se AK-ja e kishte favorizuar haptas këtë operator ekonomik kur e kishte rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin paraprak, ku i njëjti edhe pse nuk i kishte ofruar sqarimet e kërkuara AK-ja e kishte rekomanduar për kontratë.

Sa për sqarim sipas vendimit të lartcekur të OSHP-së ku i njëjti vendim e kishte obliguar AK të kërkoj sqarime shtesë nga OE Bina Delta-CCD Shpk, pyetja nga AK ka qenë e formuluar si në vijim:
Pyetja: Autoriteti kontraktues gjate rivlerësimit të ofertave ka vërejtur qe ju si grup i operatoreve ekonomik në atestet në ofertën e juaj nuk është e bashkangjitur fotografia e mostrës për të cilën është lëshuar atesti në fjalë, ju lutem na sqaroni këtë.

OE bina Delta-CCD SHPK i ka dërguar një përgjigje si në vijim:
Lidhur me B47 Lefer Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit, ku kerkoni sqarime lidhur me dokumentin A-testet ne oferten furnizim me numra identifikues per blete, ju informojme si ne vijim:
Fillimishte ne dosjen e tenderit nuk eshte kerkuar foto e produktit qe te jete e vendosur ne dokumentin A-testet, pra eshte kerkuar vetem A-testi i produktit i leshuar nga nje institut shteteror i standardeve.
Kete dokument e ka leshuar Instituti Turk i Standardeve - TSE me kerkese te kompanise me te cilen ne kemi kontrate dhe autorizim per shitje dhe distribuim ne Kosove.
Ky dokument (A-testet) i ka te gjitha kerkesat qe ju i keni paraqitur ne Dosjen e Tenderit e te cilat jane vleresuar nga TSE.
Nje institut sikur qe eshte TSE e cila eshte e akredituar edhe nga ICAR, si i vetmi institucion i BE-se per vleresimin e standardeve ne fushen e bujqesise, eshte serioz dhe se vleresimin e cilesise nuk e bene ne baze te fotove, por ne baze te prodhimtarise se kompanise Baltas.

OE Bina Delta-CCD shpk me sqarime shtesë, jo vetëm që nuk i kishte ofruar fotografitë me sqarime shtesë, mirëpo e ka injoruar tërësisht kërkesën e AK-së, kurse AK-ja edhe përkundër këtyre injorimeve e kishte rekomanduar për kontratë.

Ne me dt.06.01.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cilësuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pa bazuar, mirëpo që vendimi i saj nuk përmban ndonjë arsyetim konkret sa i përket pretendimeve tona ankimore.

AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhënë ndonjë përgjigjje konkrete, mirëpo vetëm e ka mbështetur vendimin e saj pa ndonjë arsyetim konkret dhe duke konsideruar se nuk janë shkelur nenet përkatëse për të cilat kemi pretenduar ne.
E njëjta e ka cekur se kinse nuk ka pasur zgjidhje tjetër përpos respektimit të raportit të ekspertit shqyrtues, mirëpo ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm sepse siç edhe e kemi cekur eksperti shqyrtues jep vetëm rekomandime për pretendimet ankimore të OE ankues, ndërsa paneli shqyrtues i OSHP-së i analizon dhe shqyrton edhe një herë dhe nxjerr një vendim final dhe meritor në lidhje me ato pretendime.

Andaj kur kemi parasysh faktin se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, atëherë është dashur që lënda të kthehet në rivlerësim dhe jo të anulohet aktiviteti i prokurimit duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, pasi që eksperti shqyrtues nuk merr vendime, mirëpo vetëm jep rekomandime në lidhje me çështjet kontestuese.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kërkojmë nga OSHP që të detyroj autoritetin kontraktues të anuloj vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit bie ndesh me nenin 62 të LPP-së ku parashihet qartë se kur autoriteti mund ta përfundoj aktivitetin e prokurimit : *2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*
2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Nuk janë përmbushur as kushtet që parashihen në nenin 44.5 të RRUOPP, sepse as në këtë dispozitë nuk parashihet që anulimi i një aktiviteti të prokurimit mund të bëhet me arsye të tilla. Në këtë rast nuk ka asnjë urdhër nga OSHP-ja që të anulohet aktiviteti në fjalë, prandaj AK-ja ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së dhe me nenin 44.5 të RRUOPP-së.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur kuptohet qartë se ky anulim i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe askund nuk parashihet me ligj një anulim i tillë me këto arsye.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së

aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si OSHP që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **"N.T.P. "Bletaria Egzoni"**.
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në
RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

Komisioni konstaton që 1. Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. „Bletaria Egzoni; N.T.P."GRESA - COMMERCE" Dokumenti i quajtur "A-testet" i prezantuar në ofertë është i pakupmtimtë sepse nuk është në gjuhet Shqip, Serbe apo Angleze, sikur që është kërkuar në LPP. Gjithashtu me vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së me numer protokolli 196/21 të datës 30.03.2021, thuhet se A-testet janë të kërkuara në dosjen e tenderit, faqe 17, Aneksi 1 Specifikacionet teknike të detyrueshme dhe për këtë gjenë zbatim edhe interpretimi i KRPP, pyetja nr. 66 ku ndër të tjera thuhet se: tenderi i cili ofron specifikacionet teknike në gjuhë tjetër nga ajo që është përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. Pra ky dokument, sipas Panelit Shqyrtues nuk është konform nenit 13 të LPP dhe interpretimit të KRPP-se.
2. Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. "BLETMIRI"; Bletaria Te Ahmeti SH.P.K. i mungojnë A-testet nga një institute shtetëror i cili garanton specifikat e produktit sikur që është kërkuar tek Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme.
3. Operatori ekonomik N.T.P. 'GLOBAL PARAJSA' tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk janë sjellur kontratat e realizuara me furnizime në lëmine e bletarisë në 3 vitet e fundit në vlerë min. 30,000.00 Euro.
Nuk keni dorëzuar mostrat e produktit ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë.

4. Grup i Operatorëve Ekonomik "NORA - H" SH.P.K.; Shkelçen Sylaj B.I. tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk janë sjellur kontratat e realizuara me furnizime në lëmine e bletarisë në 3 vitet e fundit në vlerë min. 30,000.00 Euro e të cilat janë të pakuptimta. Pra janë bërë në mes dy kompanive private e që nuk specifikohet çart titulli i kontratës
Mungojnë A-testet nga një institute shtetëror i cili garanton specifikat e produktit sikur që është kërkuar tek Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme.

5. Operatori ekonomik Artan Sopa B.I. tek Kërkesa parë mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë sjellur kontratat e realizuara me furnizime në lëmine e bletarisë në 3 vitet e fundit në vlerë min. 30,000.00 Euro por nuk keni sjellur dëshminë e transaksioneve. Tek korniza sipas specifikacionit nr. 2, mungon hapësira për vendosjen e pllakës me numër, mungojnë varëset tek korniza sipas specifikacionit numer 2 e të cilat shërbejnë për t'u ngjitur në koshere. Mungojnë A-testet nga një institute shtetëror i cili garanton specifikat e produktit sikur që është kërkuar tek Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme.

6. Grup i Operatorëve Ekonomik MEDIATECH & PRINT SH.P.K.; INOP DOO SABAC tek kërkesa e parë mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk janë sjellur kontratat e realizuara me furnizime në lëmine e bletarisë në 3 vitet e fundit në vlerë min. 30,000.00 Euro.
Mungon barkodi dhe shenja RKS ne pllake si dhe mungon syri që mundëson mbylljen e kornizës. Mungojnë A-testet nga një institute shtetëror i cili garanton specifikat e produktit sikur që është kërkuar tek Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme.

7. Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. PLANET; SINJALIZIMI SH.P.K. tek Kërkesa e parë mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë sjellur kontratat e realizuara me furnizime në lëmine e bletarisë në tre (3) vitet e fundit në vlerë min. 30,000.00 Euro por nuk keni sjellur dëshminë e transaksioneve bankare. Tek korniza sipas specifikacionit nr 2, mungon hapësira për vendosjen e pllakës me numër, mungojnë varëset tek korniza sipas specifikacionit numër 2 e të cilat shërbejnë për t'u ngjitur në koshere.Mungojnë A-testet nga një institute shtetëror i cili garanton specifikat e produktit sikur që është kërkuar tek Aneksi 1. Specifikacionet teknike të detyrueshme.
8. Grupi i OE BINA; DELTA - CCD SH.P.K.
Mostra e ofruar nga OE i plotëson të gjitha kriteret, perveq se pllaka tek Aneksi 1 Specifikacifikimet teknike të detyrueshme, pesha e pllakes nuk është në përputhje me kerkesat e Dosjes se Tenderit. Pra eshte kerkuar qe pesha te jete 8.2 gram (+-10%) kurse pas matjeve te kryera me peshore te kalibruar, komisioni konstaton se pesha është 10.28 gram. Pesha e kerkuar ne DT është 8.2gr (+-10%) =9.02gr dhe dallimi ne realitet është 1.26gr.
Komisoni i rivlerësimit te kesaj oferte konstaton se pesha e pllakes nuk eshte konform kerkesave te dosjes se tenderit. Mirepo komisoni bazuar ne Nenin 59 të LPP, paragrafi 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Pra bazuar ne kete, komisoni i rivleresimit rekomandon që mund të merret parasysh Neni 59, paragrafi 4, pika (i), dhe (ii) i LPP.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri

Përgjigje në Pretendime:
Sqarim hyrës: Bazuar në rrjedhën e AP në fjalë dhe dokumenteve të ngarkuara në platformen elektronike e-prokurimi, AK ka publikuar njoftimin për kontratë më 31.12.2020 ndërsa më datë 29.01.2021 është bërë hapja e ofertave. AK më datë 16.02.2021 ka publikuar B58 Njoftim mbi vendimin e AK sëbashku me letrat standarde, pas publikimit të këtij vendimi rrjedha e aktivitetit të prokurimit ka vazhduar me kërkesa për rishqyrtim dhe lënda është derguar në OSHP, ku pas vendimit nr.196/21 të PSH, AK kthen lënden në rivlersim dhe më datë 20.04.2021 publikon përseri B58 Njoftim mbi vendimin e AK sëbashku me letrat standarde. Ndërsa më datë 30.12.2022 AK

publikon vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 43 të RRUOPP-së pasi së bashku me Njoftimin mbi vendimin e AK nuk ka publikuar edhe letrat standarde. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në të dy rastet kur AK ka publikuar B58 Njoftimi mbi vendimin e AK sëbashku me vendimi janë publikuar edhe letrat standarde dhe siç e kam cekur edhe më lartë këto vendime janë publikuar më 16.02.2021 dhe 20.04.2021. Vendimi të cilin AK e ka publikuar më datë 30.12.2022 është vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit për të cilin AK është bazuar në nenin 62 paragrafi 1.1 i LPP-së dhe nenin 43 paragrafi 43.5 pika b e Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik. Prandaj bazuar në dokumentet e publikuara nga AK për këtë aktivitet të prokurimit pretendimi iOE ankues është **i pabazuar.**

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se iu është kufizuar çasja në dokumente për shkak se vendimi është publikuar më datë 30.12.2022 dhe janë përfshirë edhe ditët e festave zyrtare. **Eksperja shqyrtuese** sqaron se të gjitha AK duhet të veprojn në pajtim me nenin 5 të LPP, konkretisht paragrafi 2 i cili thotë:
2.Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Pretendimi tjetër i OE ankues që vendimi i publikuar nga AK më datë 30.12.2022 në të cilin thuhet se të gjithë OE janë të papërgjegjshëm është i paqendrueshëm pasi sipas OE ankues janë shpalur dy herë tenderues të suksesshëm nga AK. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se duke u bazuar në kërkesat e FDT dhe dokumenteve të prezentuara nga OE ankues, ky OE nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT tek Aneksi 1: Specifikimet teknike të detyrueshme:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia e përafërt për 36 muaj
1	Pllaka për mbishkrimin e numrit: Gjërësia - 5.6 cm Gjatësia - 9.5 cm **Pesha - 8.2 gram** **Mund të ndryshojë (+ - 10%)** -Pllaka duhet të jetë e prodhuar nga lënda e parë nga plastika që nuk e dëmton shëndetin e kafshëve. -Të jetë rezistentë në temperaturë +65C deri -30C -Numrat (teksti) të jetë i rezistueshëm, të mos fshihen si dhe të jetë me barkod të cilët mund të lexohen nga lexuesi. -Në katër qoshet e pllakës të jenë të vendosura katër vrima për vida. -Ngjyra e pllakës duhet të jete e verdhe, me barkod dhe shenjen RKS dhe dhjetë numra të vendosur në pllakë (p.sh RKS1234567890). -Pllaka duhet të ketë A-testet e kryera nga një institut shtetëror i cili garanton specifikat e lartë shënuara.	Copë	350000

AK ka kërkuar që pllaka për mbishkrimin e numrit të ketë peshën **8.2 gram (+/- 10%)** e që sipas kësaj i bie që pesha e lejuar e pllakës mund të jetë **8.2gram-10%=7.38gr** ose **8.2gram+10%=9.02gr**. Ndërsa sipas raportit të rivlersimit nga AK dhe fotove të prezantuara për të dëshmuar se është bërë matja e pllakes shihet se OE ankues ka prezantuar pllakën me peshë **10.28973gr** e cila del të mos jetë në përputhje më kërkesen e FDT. Prandaj ky OE ankues është i papergjegjshëm, dhe vlenë të ceket që edhe komisioni i vlerësimit të AK edhe pse ka qenë në dijeni që pllaka nuk është sipas kërkesës së AK prap ka dhënë këtë mendim:

8. Grupi i OE BINA; DELTA - CCD SH.P.K.
Mostra e ofruar nga OE i plotëson të gjitha kriteret, perveq se pllaka tek Aneksi 1 Specifikacifikimet teknike të detyrueshme, pesha e pllakes nuk është në përputhje me kerkesat e Dosjes se Tenderit. Pra eshte kerkuar qe pesha te jete 8.2 gram (+-10%) kurse pas matjeve te kryera me peshore te kalibruar, komisioni konstaton se pesha është 10.28 gram. Pesha e kerkuar ne DT është 8.2gr (+-10%) =9.02gr dhe dallimi ne realitet është 1.26gr.
Komisoni i rivlerësimit te kesaj oferte konstaton se pesha e pllakes nuk eshte konform kerkesave te dosjes se tenderit. Mirepo komisoni bazuar ne Nenin 59 të LPP, paragrafi 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Pra bazuar ne kete, komisoni i rivleresimit rekomandon që mund të merret parasysh Neni 59, paragrafi 4, pika (i), dhe (ii) i LPP.

Bazuar në faktet dhe argumentet e publikuara në platformen elektronike e-prokurimi OE ankues është i papergjegjshem dhe ankesa e tij për këtë aktivitet të prokurimit është **e pabazuar.**

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "N.T.P Bletaria EGZONI" - Gjakovë

Pretendimi i OE ankues N.T.P Bletaria Egzoni" se janë eleminuar nga AP me arsyetimin se A-testet janë prezantuar.në gjuhën turke dhe që sipas tyre këto A-teste janë prezantuar në gjuhën turke pas një lëshimi teknik dhe që të njejtat sipas tyre nuk janë specifikime teknike. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron që duke u bazuar në kërkesat e FDT të AK, A-testet janë të vendosura tek specifikimet teknike si në vijim:

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia e përafërt për 36 muaj
1	Pllaka për mbishkrimin e numrit: Gjërësia - 5.6 cm Gjatësia - 9.5 cm Pesha - 8.2 gram Mund të ndryshojë (+ - 10%) -Pllaka duhet të jetë e prodhuar nga lënda e parë nga plastika që nuk e dëmton shëndetin e kafshëve. -Të jetë rezistentë në temperaturë +65C deri -30C -Numrat (teksti) të jetë i rezistueshëm, të mos fshihen si dhe të jetë me barkod të cilët mund të lexohen nga lexuesi. -Në katër qoshet e pllakës të jenë të vendosura katër vrima për vida. -Ngjyra e pllakës duhet të jete e verdhe, me barkod dhe shenjen RKS dhe dhjetë numra të vendosur në pllakë (p.sh RKS1234567890). **-Pllaka duhet të ketë A-testet e kryera nga një institut shtetëror i cili garanton specifikat e lartë shënuara.**	Copë	350000

Prandaj duke u bazuar në kërkesat e FDT dhe opinionin nr. 7 të publikuar në web-faqen e KRPP-së i cili e sqaron këtë situatë si në vijim:

Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton:
"13.4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze"
Bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë OPINION:
Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësoj tenderin.Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim:
1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;
2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze.
Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike.
Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.

Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, **duhet të përjashtohet.**

OE ankues ka prezantuar si dëshmi A-testet e përkthyera në gjuhen shqipe të cilat kanë daten e përkthimit para datës së hapjes së oferave, por pasi që të njejtat nuk janë ngarkuar në plateformen elekronike e-prokurimi në kohën e ofertimit sëbashku me dokumentet tjera atëherë AK ka vlerësuar dokumentet siç janë prezantuar nga OE dhe ka vepruar në pajtim me opinionin e dhënë nga KRPP. Prandaj ky pretendim i OE ankues është **i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues për OE tjetër **BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** se është i papergjegjshëm për shkak se pesha e pllakes e tejkalon peshen e lejuar sipas kërkesës së AK.
Ky pretendim lidhur më këtë çështje është trajtuar në faqen 12 të këtij raporti dhe vlenë i njejti mendim nga ekspertja shqyrtuese.

Sa i përket pretendimit tjetër nga OE ankues për OE **BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri i** cili sipas OE ankues nuk ka prezantuar foto se për cilën mostër janë kryer A-testet. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK në kërkesat e FDT ka kërkuar: "*Pllaka duhet të ketë A-testet e kryera nga një institut shtetëror i cili garanton specifikat e lartë shënuara*", OE BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" lidhur më këtë kërkesë ka prezantuar një raport të egzaminimit dhe testimit i cili është në gjuhën turke dhe i përkthyer në gjuhen shqipe por që për të njejtin nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër.

Duke marrë parasysh shqyrtimin e dokumenteve të prezantuara nga OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit dhe kërkesat e FDT të AK, **Ekspertja shqyruese** ankesen e OE ankues **N.T.P Bletaria Egzoni** e konsideron si **pjeserishtë të bazuar.**

Pas shqyrtimit të ankesave të dy OE **BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** dhe **N.T.P Bletaria Egzoni – Gjakovë** dhe pas analizimit të dokumentacionit të prezantuar nga këta OE dhe kërkesave të AK, Ekspertja shqyrtuese propozon, pasi që këta OE janë të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit pasi nuk i plotësojn disa prej kërkesave të dosjes së tenderit dhe kthimi i lëndës në rivlerësim nuk do të ndryshonte vendimin paraprak të AK, atëherë AK mund të vazhdoj tutje më këtë procedurë sipas Vendimit të publikuar më 30.12.2022 nga AK- Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon Panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **"BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri** të refuzohet si e **pabazuar** dhe ankesa e **OE N.T.P Bletaria Egzoni-Gjakovë** të aprovohet si **pjeserishtë e bazuar** ndersa Vendimi për anulim të aktivitetit te prokurimit **"Furnizimi me numra identifikues për bletë"** me nr. të prokurimit: **40800-20-8639-1-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të mbetet në fuqi** dhe lënda të kthehet në **Ritender.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "BINA Sh.P.K & DELTA - CCD Sh.P.K" – Vushtrri, "N.T.P Bletaria EGZONI" - Gjakovë